



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:098741

Datë: 24.09.2024

Numri i dokumentit: 06203347

KPPP.nr. 595/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit IBAS Sh.A., me numër unik identifikues 810195257 dhe seli në Prishtinë, rr. "Tirana", nr. 91, kundër debitorëve; 1. "Andi Group 2004" Sh.P.K., me numër unik identifikues 811291046 dhe seli në Gjilan, rr. "Abdullah Tahiri", nr. 170, dhe 2. A.K., me numër personal ... dhe me adresë në Gjilan, rr. "...", nr. ..., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Avdulla Gashi, avokat me seli në Gjilan, duke vendosur sipas prapësimit të debitorëve, të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 185/24, të lejuar me datë 06.03.2024 nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, me datë 24.09.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorëve "Andi Group 2004" Sh.P.K., dhe A.K., i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 185/24, i lejuar me datë 06.03.2024 nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 185/24 i lejuar me datë 06.03.2024 nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit IBAS Sh.A., me datë 06.03.2024 ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 185/24 kundër debitorëve "Andi Group 2004" Sh.P.K. dhe A.K., ashtu që janë detyruar të njëjtit, që mbi bazën e dokumentit përmbartimor: Marrëveshja mbi Pengun e datës 05.10.2022 për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshjen për kredi për investime Nr. LO/596550262283 e datës 05.10.2022, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas

Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20240201-305 dhe Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20221007-475, t'ia paguajnë kreditorit borxhin në vlerë prej EUR 5,936.18 (me shkronja: pesëmijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë euro e tetëmbëdhjetë cent), si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitorët, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor kanë ushtruar prapësim me të cilin e kanë kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se kreditori nuk ka lejuar rikonstruktim të përmbajtjes së kontratës për linjat e kredisë e cila do të lehtësonte kthimin e kredisë sipas planit të përmbushjes, duke paraqitur para kohe propozimin për përmbarim, pasi që nuk janë vonesë por në linja të rregullta të përmbushjes së kredisë. Më tej, ka theksuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim pasi që duhet të konstatohet pjesa e borxhit të kërkuar sipas dokumentit, aktit të pengut dhe duhet të mundësohet ristrukturimi i linjave të kredisë në shumën e kërkuar si në propozimin për përmbarim. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të refuzohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar prapësimin e debitorëve me arsyetimin se i njëjti është paraqitur me qëllim të zvarritjes së procedurës përmbarimore dhe se nuk është bazuar në asnjërin prej shkaqeve në bazë të së cilave mund të paraqitet prapësimi, duke mos i mbështetur pretendimet e tij në dispozitat e nenit 69, par. 4 të LPP-së. Ka shtuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorëve se kreditori ka refuzuar çfarëdo marrëveshje për realizimin e detyrimeve, si dhe pretendimi se debitorët kanë respektuar afatin kontraktual të kredisë. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorëve ta refuzojë si të pa bazuar, si dhe të detyrohen debitorët që të kompensojnë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe shpenzimet të tjera të procedurës përmbarimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa me nenin 5, paragrafi 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore

përcaktohet se dokument përmbarues paraqet: “...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”. Në anën tjetër, me nenin 27, paragrafi 1 të LPP-së, është përcaktuar se “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.

Gjykata duke vlerësuar Marrëveshjen mbi Pengun e lidhur me datë 05.10.2022 për sigurimin e kërkesave që dalin nga Marrëveshja për kredi për investime Nr. LO/5965502622837, e datës 05.10.2022 gjeti se e njëjta është hartuar në formën e paraparë me ligj dhe është regjistruar në regjistrat publik, fakt ky që vërtetohet nga Konfirmimi mbi regjistrimit e pengut R-20240201-305 dhe Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut R-20221007-475, e po ashtu i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, dhe si të tillë përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 pika 1.7a, lidhur me nenin 27 të LPP-së, për të qenë dokument i pambarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorëve të paraqitura në prapësim mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 595/24, datë 24.09.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.